

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Isa Kelmendi dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit H. H. nga ..., të cilin e përfaqëson E. A. avokat nga ..., kundër të paditurit Aeroporti Ndërkombëtar “Limak Kosova” sh.a. në Prishtinë, të cilin e përfaqëson F. Gj., nga Prishtina, për shkak të anulimit të njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës , duke vendosur lidhur me revizionin e të autorizuarit të paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3565/2015 datë 29.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 07.02.2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Pranohet si pjesërisht i bazuar revizioni i të autorizuarit të paditësit , dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3565/2015 datë 29.10.2018, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.224/2014 datë 19.05.2015, ashtu që miratohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit H. H., nga ..., anulohet njoftimi i të paditurit për mos vazhdimin e kontratës së punës së paditësit, i datës 3 mars 2014, dhe detyrohet i padituri Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “L. K.” , që në afat prej 7 ditëve nga dorëzimi i aktgjykimit, paditësin ta kthejë në punë dhe detyra të punës “kargo ngarkim” si dhe brenda të njëjtit afat, për shkak të mos realizimit të ardhurave personale për periudhën kohore prej datës 04.04.2014 e deri më datën 08.05.2015, t’ia shpërblejë paditësit dëmin material: neto pagën në shumën prej gjithsej 8.007,80 €, kontributin pensional në shumën prej 446,00 € dhe tatimin në pagë në shumën prej 482,83 €, apo shumën totale prej 8.936, 63 €, me kamatë prej 8 % në vit, duke filluar nga data 08.05.2015 kur është kryer ekspertiza financiare e deri në pagesën definitive, , si dhe t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 972 €.

Kërkesëpadia e paditësit përtej pjesës së gjykuar edhe për shumën prej 975,78 € refuzohet si e pa bazuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3565/2015 datë 29.10.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.224/2014 datë 19.05.2015, me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit që të anulohet vendimi-njoftimi i të paditurës për mos përtëritjen e kontratës së punësimit i datës ..., dhe të detyrohet e paditura që në afat prej 7 ditësh nga dorëzimi i aktgjykimit paditësin ta kthejë në vendin dhe detyrat e punës “kargo ngarkim” dhe që t’ia paguajë dëmin material në shumë totale prej 9.912,414 €, për shkak të mos realizimit të ardhurave personale për periudhën kohore prej datës 04.04.2014 e deri më datën 08.05.2015, si dhe t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë , i autorizuari i paditësit në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni i paditësit të aprovohet si i bazuar dhe të dy aktgjykimet të ndryshohen ashtu që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit , si dhe shpenzimet procedurale të precizuara në seancën e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë, në të cilat duhet llogaritur edhe shpenzimet e përpilimit të revizionit dhe taksës gjyqësore për revizion, në shumë prej 363,00 €, apo të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se:

Revizioni i të autorizuarit të paditësit është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi tek paraardhësi i të paditurit ANP “. J.”, ka qenë në marrëdhënie pune që nga data 07.05.2004, e deri në dhënien me koncesion të këtij aeroporti më 2011, dhe edhe më tutje, kur me kontratën e punës në shkesat e lëndës , paditësja tek i padituri për të njëjtin vend pune ka lidh marrëdhënie pune për kohë të caktuar duke filluar nga data 04.04.2011 gjer më datën 03.04.2014, ku në nenin 1.1 të kësaj kontrate , përveç kësaj, është paraparë që varësisht nga kushtet e kompanisë dhe rrethanat operationale, si dhe performancës së të punësuarit , kontrata mund të vazhdohet edhe për vitin në vijim. I padituri me njoftimin e datës ..., e njofton paditësin se kontrata e punës i përfundon më datën 03 prill 2014 në pajtim me politikat e Bordit të drejtorëve dhe në pajtim me Ligjin e Punës të

Kosovës nr.03/L-2012, duke u bazuar në vendimin e kompanisë për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore. Nuk është kontestues fakti se i padituri nuk ka zhvilluar ndonjë procedurë të brendshme për ndërprerjen e kontratës së punës apo për të pasur si pasojë mos vazhdimin e saj , e me këtë edhe të marrëdhënies së punës së paditësit. Paditësi duke konsideruar se njoftimi i tillë i të paditurit është i kundërligjshëm, më datën 16.04.2014, ka paraqitur padi duke kërkuar mbrojtjen e të drejtës së tij të punës, pasi që paraprakisht tek i padituri ka paraqitur kërkesë që njoftimi për mos përtëritjen e kontratës së punës të anulohet si jo i ligjshëm dhe paditësi të kthehet në vendin e më parë të punës , mirëpo këtë kërkesë i padituri e kishte refuzuar me përgjigje në kërkesë , më datën 20 mars 2014.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave gjeti se njoftimi mbi mos vazhdimin e kontratës së punës së paditësit është ligjore pasi që paditësit marrëdhënia e punës i është ndërprerë në bazë të nenit 67 të Ligjit të Punës, për faktin se paditësi tek i padituri ka pasur statusin e punëtorit me kohë të caktuar nga data 04.04.2011 deri më datën 03.4.2014 dhe me skadimin e afatit të kontratës i padituri nuk ka pas obligim ligjorë që paditësit t’ia vazhdoj kontratën e punës, për arsye se nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 10 par. 5 të Ligjit të Punës, që të konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore. Prandaj, e refuzoi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit për anulimin e njoftimit për mos përtëritjen e kontratës së punës së paditëses dhe detyrimin të paditurit që paditësin ta kthejë në punë dhe detyrat e punës ku ka punuar, si dhe t’ia paguajë dëmin e shkaktuar material për shkak të mos realizimit të ardhurave, me detaje tjera të përshkruara më gjerësisht si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, për arsyet e njëjta faktike dhe juridike në tërësi e pranoi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, andaj e refuzoj si të pabazuar ankesën e të autorizuarit të paditëses dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e vërtetoi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykatat e instancës ma të ulët gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale(224.1 të LPK), kur kanë gjetur se njoftimi i të paditurit për shkëputjen e kontratës së punës është i ligjshëm, pasi që paditësit marrëdhënia e punës i është ndërprerë në bazë të nenit 67 të Ligjit të Punës, dhe procedurës të përcaktuar me nenin 71 par. 2 të Ligjit të Punës dhe nenit 1.1 të Kontratës së Punës e cila ishte me kohë të caktuar në periudhën prej datës 04.04.2011 e deri më datën 03.04.2014, e që pas kësaj periudhe nuk bartë asnjë obligim ndaj paditësit. Ky përfundim i

gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me shkresat e lëndës pasi që nga provat që gjinden në shkresa të lëndës, konkretisht Njoftimi i të paditurit me shkrim i datës ..., rezulton se, paditësit nuk i është vazhduar kontrata e punës në pajtim me politikat e Bordit të Drejtorëve, Ligjit të Punës të Kosovës si dhe vendimit për Planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore dhe Marrëveshjen për Partneritetin Publik Privat (PPP), të lidhur në mes të paditurit dhe Republikës së Kosovës, ashtu siç theksohet në këtë njoftim.

I padituri ka dështuar për të vërtetuar të gjitha pretendimet e tij lidhur me ligjshmërinë e njoftimit për mos vazhdimin e kontratës së punës së paditësit si dhe vërtetimin e fakteve relevante nëse i padituri ka përpiluar një plan të detajuar operativ, në të cilin do të përcaktohej se cilat shërbime mund të reduktohen dhe në çfarë përfshirje do të duhej të ishin riedukuar, me qëllim të vërtetimit të faktit se provat e parashtruara , paraqesin bazë të vlefshme ligjore për mos përtëritjen e kontratës së punës së paditësit, se i padituri ka vepruar në pajtim me vendimin e ligjshëm që i plotëson standardet ligjore për mos vazhdimin e kontratës së punës dhe të atyre që rregullojnë procedurat e shkëputjes së kontratës, andaj dështimi i të paditurit në këtë drejtim, mos vazhdimin e kontratës së punës e bën të paligjshëm .

Gjykata Supreme e Kosovës nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune me kohë të caktuar dhe nuk ka pasur 10 vite punë të pa ndërprerë që në kuptim të nenit 10.5 të Ligjit të punës, marrëdhënia e punës së paditësit të trajtohet me kohë të pacaktuar, për arsye se objekt i kërkesëpadisë së paditësit nuk është vërtetimi i ekzistimit të marrëdhënies së punës së paditësit në kohë të pacaktuar por vlerësimi i ligjshmërisë së njoftimit për mos vazhdimin e kontratës së punës, i cili njoftim është marrë në kundërshtim me Ligjin e Punës, që është ligj themelor që rregullon marrëdhënien e punës në Kosovë, ku është përcaktuar baza dhe procedurat për ndërprerjen e kontratës së punës së punëtorit, të cilat procedura i padituri nuk i ka respektuar me rastin e mos vazhdimit të kontratës së punës së paditësit që si rrjedhojë rezulton se mos vazhdimi i kontratës së punës së paditësit është i kundërligjshëm.

Paditësi tek paraardhësi i të paditurit dhe tek i padituri ka qenë në marrëdhënie pune me kohë të caktuar nga data 07.05.2004 e deri më datën 03.4.2011, kur është dhënë me koncesion ANP “Adem Jashari”, dhe edhe më tutje, deri kur me kontratën e fundit i është vazhduar marrëdhënia e punës gjer më datën 03.04.2014, edhe pse vendi i punës ka qenë i natyrës së përhershme. Kontratat e tilla sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, janë në kundërshtim

me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë, ku për 9 vite, 10 muaj dhe 27 ditë vazhdimisht paditësi mbahet në gjendje të pasigurt juridike të marrëdhënies së punës, me vazhdimin e marrëdhënies së punës në kohë të caktuar, dhe më në fund me një njoftim mos vazhdimi i kontratës së punës nuk ka mbështetje ligjore. Punëmarrësi nuk mund të heq dorë nga të drejtat e punëtorëve që rrjedhin nga dispozitat urdhëruese të nenit 5 par. 1 të Ligjit të Punës, ku parashihet se është i ndaluar çfarëdo diskriminimi në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet tjera në fuqi. I padituri ka dështuar për ta argumentuar faktin se në rastin e zbatimit të Marrëveshjes PPP të lidhur në mes të paditurit dhe Republikës së Kosovës, i është përmbajtur ndalimit të diskriminimit, të paraparë me nenin 5.1 të Ligjit të Punës.

Sipas njoftimit mbi mos vazhdimin e kontratës së punës del se paditësit kontrata e punës nuk i është vazhduar nga baza e vendimit të kompanisë për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore, i cili vendim asnjëherë nga ana e të paditurit nuk i është prezantuar gjykatës dhe as që është prezantuar plani i ardhshëm i resurseve njerëzore, si bazë për vlefshmërinë e njoftimit. Në këtë çështje konkrete, i padituri nuk ka respektuar rregullat primare të procedurës dhe detyrimin e tij që gjykatës t'ia prezantojë faktet, mbi të cilat mbështetë pretendimet e veta dhe nuk ka prezantuar prova me të cilat do të kishte provuar bazueshmërinë e pretendimeve, andaj dështimi i të paditurit në këtë drejtim, mos vazhdimin e kontratës së punës së paditëse e bën jo ligjor.

Për këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës, gjen se revizioni i paditësit është i bazuar, kështu që për shkak se gjendja faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë dhe e dytë nuk vihet në pyetje, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale ka mundësi ligjore që në pajtim me nenin 224.1 të LPK, të ndryshohen aktgjykimet e lartë përmendura dhe të miratohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit.

Miratimi i kërkesëpadisë së paditësit nuk është në kundërshtim me Marrëveshjen për Partneritetin Publik Privat të lidhur mes të paditurit dhe Republikës së Kosovës, ashtu si pa bazë pretendon i padituri pasi që me nenin 9.18 të kësaj Marrëveshje nuk parashihet edhe ndërprerja e kontratave të punësimit të punëtorëve në kundërshtim me ligjet pasi që me këtë Marrëveshje, parashihet që partneri privat, këtu i padituri, mund të pranoj punësimin ose ndonjë angazhim të çfarëdo punëtori të ANP-së, në çdo kohë për çështjet në lidhje me ligjin,

rregullat dhe Rregulloret administrative dhe dekretet e aplikuara sipas Marrëveshjes së përbashkët dhe pa kufizime, pas përvjetorit të tretë të hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje.

Kjo gjykatë po ashtu vlerëson se kërkesëpadia e paditësit përkitazi me kompensimin e të ardhurave personale është e bazuar në ligj (në nenin 136 të LMD-së), pasi që largimi nga puna i paditësit vlerësohet si i paligjshëm dhe për këtë arsye paditësit i takon e drejta në kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna, në shumën e vërtetuar nga ana e ekspertizës financiare të ekspertes financiare gjyqësore M. M., e datës 08.05.2015, në shumë prej 8.936,63 €, me kamatë vjetore prej 8 % (sipas nenit 382.2 të LMD), duke filluar nga data 08.05.2015 kur është kryer kjo ekspertizë, e deri në pagesën e plotë, për shkak të mosrealizimit të ardhurave personale për periudhën kohore prej datës 04.04.2014 e deri me 08.05.2015, për të cilën periudhë kohore në kuptim të nenit 1.1 të kontratës së punës, varësisht nga kushtet e kompanisë dhe rrethanat operationale si dhe performansës së të punësuarit, kontrata e punës paditëses, ka pasur mundësi ti vazhdohet.

Kërkesëpadia e paditësit përtej pjesës së gjykuar e në shumën prej 975,78 u refuzua si e pa bazuar pasi që kishte të bëjë me kamatë të kapitalizuar, në të cilën shumë përsëri të rrjedh kamata, gjë që do të ishte në kundërshtim me nenin 379 par.2 të LMD.

I padituri në bazë të nenit 452.1 të LPK, ka për obligim që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë të përgjithshme prej 972,00 euro, ku përfshihen 104,00 € për përpilimin e padisë nga ana e avokatit, përfaqësimi për tri seanca nga 135,00 € për secilën seancë, për ekspertizë financiare 100,00 € dhe për revizion shuma prej 363,00 €, sipas Tarifës së Avokatëve.

Nga sa u tha më sipër e në mbështetje të dispozitës së nenit 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.16/2019 datë 07.02.2019

Kryetar i kolegjit,
Shukri Sylejmani

